



Karta e Shërbimeve / Udhëzuesi i Pacientit / Manuali

Mirë se vini në Spitalin Katolik "Nostra Signora Del Buon Consiglio"	pag.
Misioni	pag.
Kush jemi	pag.
Lista e specialiteteve	pag.
Diagnostika imazherike	pag.
Laboratori i Analizave	pag.
Kirurgjia e Përgjithshme	pag.
Terapia Intensive	pag.
Pranimi dhe Shtrimi në Spital	pag.
Klinika Universitare e Stomatologjisë	pag.
Qendra e Fizioterapisë dhe Rehabilitimit	pag.
Poliklinika "P. Luigi Monti"	pag.
Gjëra që duhet të dini	pag.
Të drejtat e pacientit dhe Përgjegjësitë	pag.
Marrëveshjet dhe Sigurimet	pag.
Kërkesa për kopje të raporteve	pag.
Shërbime të tjera	pag.
Rëndësia e feedback-ut për shërbimet tona	pag.
Informacione të dobishme	pag.
Dokumente të nevojshme	pag.
Tarifat	pag.
Mënyrat e pagesës	pag.
Si të na arrini	pag.
Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë	pag.

Karta e Shërbimeve përmban informacione dhe detaje mbi organizimin e "Spitalit Katolik Nostra Signora del Buon Consiglio" si dhe për shërbimet e ofruara.

Karta e Shërbimeve është një mjet informativ i thjeshtë dhe i lehtë për t'u konsultuar, në përputhje me atë që parashikohet nga Ligji nr. 55/2022.

Ajo synon të mbrojë të drejtat e Përdoruesit përmes:

- njohjes së të drejtës për informacion;
- verifikimit të cilësisë së shërbimeve të ofruara;
- njohjes së të drejtës për ankesë;
- verifikimit të shkallës së kënaqësisë së Përdoruesve;

Mbrojtja e shëndetit si një pasuri kolektive dhe individuale është në qendër të objektivave që synon Spitali Katolik "Nostra Signora del Buon Consiglio".



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Mirësevini në Spitalin Katolik “Nostra Signora Del Buon Consiglio”

Faleminderit që na besuat dhe na zgjodhët!

Spitali Katolik NSBC filloi aktivitetin e tij në vitin 2022 dhe është spitali i parë jofitimprurës i hapur në Shqipëri.

Që nga hapja e tij, ne kemi punuar për të ndërtuar një qendër shëndetësore për diagnostikimin, kirurgjinë dhe për trajtimin e sëmundjeve, ku pacienti me nevojat e tij, është i vendosur në qendër.

Shëndeti dhe mirëqenia juaj janë prioritetet tona kryesore, sepse Ti je pjesa më e rëndësishme e punës tonë.

Të ftojme të kesh një rol aktiv në lidhje me kujdesin tënd dhe të garantojmë se jemi të ndjeshëm ndaj nevojave të tua specifike.

Stafi ynë dëshiron t'ju trajtojë jo si pacientë, por si partnerë të informuar mirë, që e njohin mirë të drejtën dhe përgjegjësitë e tyre.

Ky manual është hartuar nga stafi i Spitalit për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja.

Spitali NSBC ka një degë për aktivitetet ambulatoriale, në “Poliklinikën P. Monti”, e cila ndodhet në Rrugën e Kavajës, nr. 105.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Misioni

Fondacioni “Nostra Signora del Buon Consiglio” (NSBC), nga i cili “Spitali Katolik” është një pjesë e pandarë, është një Ent Juridik i së Drejtës shqiptare.

I themeluar në vitin 1993 nga Congregazione dei Figli dell’Immacolata Concezione (CFIC), ai përfaqëson në Shqipëri qëllimin dhe frymën e karizmës evangelike të një religjiozi italian, Luigi Maria Monti (Bovisio Masciago 1825 – Saronno 1900), infermier dhe edukator.

Fondacioni ka tre fusha ndërhyrjeje dhe ka si prioritet në Shqipëri, arsimin, kërkimin shkencor dhe kujdesin për personat e sëmurë.

Me këto qëllime, ka themeluar Universitetin Katolik “Nostra Signora del Buon Consiglio”, i cili përmes arsimit universitar siguron një formim për jetën, “Poliklinikën P. Monti”, dhe Spitalin Katolik “Nostra Signora Del Buon Consiglio”, të cilat ofrojnë shërbime kujdesi.

Këto janë dy parime themelore të misionit kristian, i cili për shekuj ka parë angazhimin e vazhdueshëm ndaj njerëzve që jetojnë në kushte të vështira.

Ushtrimi i këtij aktiviteti në Shqipëri përbën një shembull cilësie, në kuadër të iniciativave të solidaritetit: jo më vetëm ndërhyrje emergjente, por ndërhyrje që kanë një impakt të fortë për zhvillimin e komunitetit, për rritjen dhe për formimin e njeriut.



Kush jemi

Spitali Katolik "Nostra Signora Del Buon Consiglio" ndodhet në "Rrugën Dritan Hoxha" dhe në "Rrugën Ana Komnena, Nr. 74, 1023", Laprakë – Tiranë.

Ai është i vendosur afër qendrës së qytetit të Tiranës dhe synon të ofrojë, si një qendër spitalore, shërbime të kualifikuara për diagnostikimin dhe trajtimin me cilësi të lartë, falë bashkëpunimit me specialistë të ndryshëm në fushën e shëndetësisë.

Objektivi i Spitalit Katolik është të vendosë në qendër të aktivitetit të tij nevojat e pacientit, gjendjen e tij shëndetësore, me respekt për dinjitetin dhe privatësinë e tij, duke ofruar kujdesin njerëzor dhe kompetencën profesionale të nevojshme për të përmbushur çdo nevojë për diagnozë dhe trajtim. Për të arritur këtë qëllim, Spitali përdor një ekip profesionistësh që ndan dhe ndjek përmirësimin e cilësisë përmes analizës së rezultateve dhe zbatimit të principeve etike.

Spitali Katolik është i pajisur me një recepcion për të mirëpritur pacientët dhe për të përfunduar procedurat burokratike, ambulatorë për vizita specialistike dhe analiza diagnostike, si dhe dhoma pritjeje. Ai karakterizohet nga një gamë e gjerë shërbimesh, duke qenë një pikë referimi specialistike e plotë dhe efektive për nevojat e përdoruesve.

Spitali Katolik përdor staf mjekësor dhe paramjekësor të specializuar, pajisje moderne dhe efektive, si dhe sisteme informatike në evolucion të vazhdueshëm për rezervimin dhe menaxhimin e të dhënave, për të arritur diagnoza të sakta.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Lista e specialiteteve ambulatorale

Alergologjia
Anestezi - Reanimacion
Angiologjia
Kardiologjia
Kirurgjia e Përgjithshme
Kirurgjia Maksilo Faciale
Dermatologjia
Hematologjia
Endokrinologjia
Fizioterapia
Gastropatologjia / Endoskopia digjeste
Gjinekologjia
Laboratori biokimik
Laboratori mikrobiologjik
Laboratori Anatomia Patologjike
Laboratori Biologjia Molekulare
Sëmundjet infektive
Mjekësia e Brendshme
Neurologjia
Nefrologjia
Nutricionistika
Okulistika
Odontoiatria
Onkologjia
Ortopedia
ORL
Pediatria
Pneumologjia
Psikiatria
Psikologjia
Radiologjia
Reumatologjia
Urologjia



Diagnostika për Imazhet

Diagnostika imazherike përdoret kryesisht për përcaktimin e diagnozës mjekësore; në fakt, ajo është dega e mjekësisë që merret me marrjen e imazheve të organeve dhe indeve për diagnozën ose trajtimin e sëmundjeve. Mjeku radiolog asiston specialistët e tjerë në diagnozën dhe trajtimin e sëmundjeve, duke ofruar dhe interpretuar imazhe të organeve dhe indeve të brendshme të trupit. Ai di të sugjerojë cilat teste të kryhen dhe di t'i interpretojë ato për të kontribuar në një diagnozë dhe trajtim të përshtatshëm.

Në "Spitalin Katolik" ofrohen shërbimet e mëposhtme:

TAC (CT Scanner);

RMI (Risonanca Magnetike);

Radiologjia Digjitale (RX);

Ekografia/Elastografia;

Mammografia (Tomosintesi);

Dexa (Osteodensitometria Kockore);

Radiografia ortopanomike dentare;

Radiologjia Interventistike.

- TAC (CT Scanner) është një metodë diagnostike jo invazive që përdor rrezatimin X për të marrë imazhe tridimensionale të zonave anatomike specifike të trupit njerëzor.
- RMI (Rezonanca Magnetike) është një teknikë diagnostike që zbulon imazhe të detajuara të trupit njerëzor dhe përdor fusha magnetike për të ndihmuar mjekët në diagnostikimin e sëmundjeve të ndryshme, kur metodat e tjera të imazheve janë të pamjaftueshme.
- Radiografia digjitale (Rx) është veçanërisht e rëndësishme dhe e përdorur, pasi është një metodikë e shpejtë, e thjeshtë dhe relativisht ekonomike: jashtëzakonisht e qartë dhe e detajuar në studimin e patologjive.
- Mamografia është një ekzaminim radiografik jo invaziv i gjirit që lejon mundësinë e ekzaminimit të strukturave të gjendrave dhe identifikimin e ndryshimeve në strukturën dhe densitetin e gjirit
- Tomosintesa Digjitale, e quajtur gjithashtu mamografia tridimensionale 3D, është teknika më moderne për identifikimin e patologjive të gjirit. Ajo redukton dhe/ose eliminon efektin e mbivendosjes së indeve tipike të teknikes 2D, përmes marrjes së imazheve nga kënde të ndryshme të një gjiri me ndihmën e rikonstruktimit të segmenteve individuale ose shtresave me rezolucion të lartë.
- Dexa (Osteodensitometria Kockore) shërben për të përcaktuar densitetin/fortësinë e kockave (përmbajtjen minerale të kockave) me ndihmën e një ekzaminimi të veçantë radiografik.
- Ekografia është një metodikë diagnostike jo invazive që, duke përdorur ultratinguj, lejon vizualizimin dhe studimin e të gjitha organeve ose indeve të buta.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

- Elastografia është një metodikë diagnostike me ultratinguj që është në gjendje të vlerësojë në mënyrë jo invazive shkallën e elasticitetit të indeve të mëlçisë në cirrozë, të gjirit në patologjitë e gjirit ose të tiroides.
- Radiografia panoramike dentare është një teknikë që prodhon imazhe dentare dhe baza kockore të fytyrës.
- Radiologjia Interventistike përfshin një gamë procedurash invazive si trajtimi i tumorëve, biopsia e organeve, drenazhet e ndryshme, etj.



Laboratorii analizave

Laboratori i spitalit është i organizuar në:

1. **Biokimik**
2. **Mikrobiologjik**
3. **Anatomia patologjike (Pap Test, Biopsi, Citologji, Imunohistokimi)**
4. **Biologjia Molekulare**

Siguria në menaxhimin e të dhënave të pacientëve, ndjekja e proceseve dhe kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë, udhëheqin çdo ditë aktivitetet e stafit të specializuar të Laboratorit. Pajisjet e Laboratorit lejojnë plotësimin e menjëhershëm dhe në mënyrë plotësisht të besueshme të çdo nevoje.

"Spitali Katolik" ofron një gamë të gjerë analizash dhe një nivel të lartë specializimi e kompetence të stafit. Përveç specialiteteve të ndryshme klinike, laboratori ofron analiza të dedikuara dhe të orientuara drejt parandalimit: Check Lab - paketa analizash laboratorike, të destinuara për screening e patologjive specifike për grupe (meshkuj, femra); për të vlerësuar, në një moment të vetëm, gjendjen e shëndetit për të parandaluar sëmundje të mundshme ose për t'i mbajtur ato nën kontroll.

"Spitali Katolik" gjithashtu ka një laborator të rëndësishëm për histopatologjinë molekulare për aplikimin e teknikave të biologjisë molekulare për qëllime diagnostike dhe terapeutike. Histopatologjia molekulare identifikon ndryshimet kromozomike, mutacionet ose anomali të tjera gjenetike në indin tumoral për të saktësuar diagnozën dhe për të përcaktuar një terapi onkologjike të personalizuar. Në rastet e ndërhyrjeve kirurgjikale te pacientët onkologjikë, bëhet një ekzaminim ex-tempora për të analizuar shpejt mostrën e indeve të marrë, duke i mundësuar mjekëve të marrin vendime të menjëhershme dhe të fokusuar lidhur me trajtimin, duke optimizuar kështu rezultatet klinike dhe duke garantuar një qasje më efektive dhe specifike për secilin pacient.



Kirurgjia

Sot, kirurgjia moderne është evoluar shumë dhe është përshtatur sipas nevojave të pacientëve. Ajo bazohet në përdorimin e teknikave inovative më pak invazive (si laparoscopia), të cilat lejojnë një rikuperim më të shpejtë, me përdorimin e pak barnave, më pak toksike dhe më të përshtatshme për situatën specifike. Në këtë mënyrë, shmanget gjithashtu qëndrimi në spital, duke reduktuar kostot përkatëse.

Kjo tendencë e re bëhet thelbësore në kirurgjinë “Day Surgery”, ku pacienti i operuar kthehet në shtëpi brenda mbrëmjes. Një rol të rëndësishëm, përveç kirurgut, luan edhe anesteziisti, i cili ka detyrën delikate të përdorë substanca të lehta për t'u shpërbërë dhe në doza minimale, për të garantuar një rikuperim post-operativ të shpejtë.

Në "Spitalin Katolik", kryhen ndërhyrje në kirurgji dhe në “Day Surgery”, të shkurtra dhe me mesatare, në anestezi lokale, sedacion loco-regionale dhe anestezi të përgjithshme, në specialitetet e mëposhtme:

- ☒ **Kirurgjia Gjenerale**
- ☒ **Kirurgjia Gjinokologjike**
- ☒ **Kirurgjia ORL (Otorinolaringologjike)**
- ☒ **Kirurgjia Okulistike**
- ☒ **Kirurgjia Ortopedike & Traumatologjike**
- ☒ **Kirurgjia Oro/Maxillofaciale**
- ☒ **Kirurgjia Plastike**
- ☒ **Kirurgjia Senologjike**
- ☒ **Kirurgjia Torakale**
- ☒ **Kirurgjia Urologjike**
- ☒ **Kirurgjia Vaskulare**

Para çdo ndërhyrjeje ose procedure kirurgjikale, do të kërkohet të nënshkruani një formular paraprak dakordësimi. Lexojeni me kujdes dhe sigurohuni që të ketë informacionet e duhura, si dhe llojin e kirurgjisë/procedurës që do të kryhet. Infermierja juaj mund t'iu ndihmojë t'ua shpjegojë atë. Për cdo dyshim që keni, përfshirë edhe ato për barnat që duhet të merrni në shtëpi, pyesni mjekun dhe/ose infermierin; ata do t'ju japin të gjitha shpjegimet e nevojshme.



Terapia Intensive

Terapia Intensive është një repart spitalor i dedikuar për monitorimin dhe trajtimin intensiv të pacientëve kritikë, që kryhet 24 orë në ditë. Aktivitetet janë të orientuara ndaj individëve të prekur nga një ose më shumë dështime të organeve akute, potencialisht të kthyeshme, të cilat paraqesin rrezik për jetën dhe rrezik për shfaqjen e komplikacioneve më të mëdha, duke e bërë kritike menaxhimin e tyre në një repart të zakonshëm të shtrimit.

Pacientët e përshtatshëm për shtrim në Terapinë Intensive ndahen në dy kategori të mëdha, si më poshtë:

- Pacientët që kërkojnë monitorim dhe trajtim sepse një ose më shumë funksione jetësore janë të kërcënuara nga një patologji akute ose kronike (p.sh.: sepsi, infarkti i miokardit, hemorragjia gastrointestinale) ose si pasojë e një trajtimi kirurgjik ose të një lloji tjetër intensiv (p.sh.: ndërhyrje perkutane), që çon në kushte të rrezikshme për jetën.
- Pacientët që tashmë kanë dështim të njërit nga funksionet jetësore, si funksioni kardiovaskular, respirator, renal, metabolik ose cerebral, por me një mundësi të arsyeshme për një rikuperim të konsiderueshëm funksional. Në parim, nuk pranohet pacientë në stadin e patologjisë terminale që nuk është e shërueshme. Ndonjëherë, megjithatë, mund të merret parasysh nevoja për kujdes palativ që kërkon masa të terapisë intensive.



Pranimi dhe shtrimi

Pranimi dhe Dokumentacioni i Nevojshëm për Shtrimin:

Në momentin e shtrimit, është e nevojshme të shkoni në sportelin përkatës (pranë Arkës) ku kryhet pranimi dhe jepen të gjitha informacionet dhe udhëzimet në lidhje me ndërhyrjen e mundshme, mënyrat e shtrimit, ofertat, kostot e shtrimit, si dhe emrin e mjekut referues.

Çfarë të sjellësh me vete për qëndrimin në spital:

Është e domosdoshme të sillni me vete (për t'ia dorëzuar Mjekut të repartit dhe/ose Koordinatorit të infermierisë ditën e hyrjes) të gjitha ekzaminimet ose dosjet mjekësore të mëparshme dhe informacionet lidhur me barnat që merrni zakonisht.

Veshja duhet të jetë sa më minimale të jetë e mundur.

Rekomandohet të mos sillni objekte me vlerë ose sasi parash. Megjithëse të gjitha dhomat janë të pajisura me kasaforta personale për të ruajtur objekte të çmuara, Spitali nuk është në asnjë rast përgjegjës për vjedhjet ose humbjet e pasurive që lihen pa mbikëqyrje.

Vizitat e të Afërmeve dhe Miqve:

Pacientët e shtruar mund të pranojnë vizita, me kusht që kjo të jetë në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore dhe udhëzimet e dhëna nga mjeku kujdestar. Si rregull, numri i vizitorëve nuk duhet të kalojë dy persona në një kohë. Nuk është e papërshtatshme të lejoni fëmijë nën 12 vjeç të hyjnë në spital.

Për arsye higjienike, është e ndaluar të uleni në shtratin e pacientëve dhe të përdorni tualetet e dhomave të shtrimit.

Për vizitorët janë në dispozicion shërbime higjienike të veçanta.

Gjatë aktiviteteve shëndetësore, të afërmit janë lutur të dalin nga dhomat.

Rekomandohet të mos sillni ushqime ose pije për pacientët në mënyrë që të mos ndryshoni regjimin dietetik të parashikuar.

Orari i Vizitave:

- **Pavoni i shtrimeve:** nga ora 11:00 deri në 12:00 dhe nga ora 17:00 deri në 19:00, përveç nëse ka dispozita të tjera. Qëndrimi i një shoqëruesi është i mundur, për arsye të veçanta, vetëm me autorizimin paraprak të Koordinatorit të Infermierisë. Për pacientët mbi 65 vjeç, vizita e të afërmeve lejohet gjithashtu jashtë orareve të vizitave. Kjo është në përputhje me garantimin e të drejtës për shoqërim. Për fëmijët, lejohet prania e vazhdueshme e një prindi.
- **Terapia Intensivë:** nga ora 11:00 deri në 12:00 dhe nga ora 17:00 deri në 19:00.

Shërbimi Religjioz: Një kapelë e dedikuar kultit katolik është në dispozicion të publikut, por gjithashtu e aksesueshme për besimtarët e feve të tjera.

Për më shumë informacion:

- Në lidhje me shtrimet ose shërbimet ambulatorë, mund të kontaktoni numrat +355 44 505 004, WhatsApp +355 69 70 77 550 ose të shkruani në email info@zoja.al.
- Për shërbimet ambulatorë, mund të kontaktoni numrat +355 44 505 004, WhatsApp +355 69 70 77 550 ose të vizitoni faqen www.zoja.al.



Klinika Universitare Odontoiatrike

Klinika Universitare Odontoiatrike “Nostra Signora Del Buon Consiglio” është një nga strukturat klinike më të mëdha në Tiranë që ofron shërbime odontoiatrike të nivelit të lartë dhe ndodhet pranë Universitetit Katolik “Nostra Signora del Buon Consiglio”.

Ekipi i odontologëve të kësaj strukture shëndetësore është shumë i kualifikuar dhe vazhdimisht i përditësuar mbi degët e ndryshme të odontologjisë, për të garantuar një cilësi të lartë të shërbimeve odontoiatrike. Klinika siguron diagnoza klinike të sakta dhe trajtime të kryera duke përdorur teknika të avancuara dhe materiale të gjeneratës së fundit.

Shërbimet që ofrojmë:

- ☒ Terapi dhe Endodonti
- ☒ Protezë fikse dhe e lëvizshme
- ☒ Kirurgjia orale
- ☒ Ortodonci dhe Pedodonti
- ☒ Parodontologjia
- ☒ Implantologjia
- ☒ Radiologjia dentale

Në klinikën tonë, vizitat e para kryhen nga një staf i specializuar në bazë të problematikës që shfaqet në rastin klinik, me qëllim të diagnostikimit të thelluar të rastit. Gjatë vizitës së parë, odontologu vlerëson situatën e kavitetit oral të pacientit, duke identifikuar nëse pacienti ka lëzime kariesh, sëmundje parodontale, mal okluzione, patologji orale inflamatore ose tumorale, ose nëse ka nevojë për rehabilitim me protezë me ndihmën ose jo të implanteve dentale. Në fund, paraqitet plani i trajtimit dhe oferta për pacientin.

- Për informacion dhe shërbime, mund të kontaktoni numrat +355 4 22 73 294, WhatsApp +355 69 70, ose të shkruani në email info@zoja.al ose të vizitoni faqen www.zoja.al.

Klinika Odontoiatrike bashkëpunon me disa institucione akademike italiane dhe kontribuon në formimin dhe diplomimin e studentëve të Programit të Studimeve në Odontologji të Universitetit Katolik “Nostra Signora del Buon Consiglio”.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Klinika e Fizioterapise dhe reabilitimit

Që nga Dhjetori 2008 operon Klinika e Fizioterapisë dhe Reabilitimit. Struktura e saj, e cila shtrihet në më shumë se 1,000 m² sipërfaqe, ofron një ambient të përshtatshëm për të ofruar terapi sipas standardeve më moderne, në përputhje me çdo terapi rehabilituese, me ambiente për terapi dhe kujdes, palestra me pajisje për ushtrime të ndryshme, shkallët për ngjitje dhe zbritje, si dhe shkallët suedeze.

E veçantë në panoramën shqiptare është pishina e hidrokinezoterapisë për reabilitimin në ujë, me një temperaturë konstante dhe pa pengesa arkitektonike, e aksesueshme për çdo patologji invaliduese.

Shërbimet që ofrojmë:

- ☒ Vizita mjekësore
- ☒ Vlerësimi fizioterapeutik i posturës
- ☒ Terapia manuale
- ☒ Gjimnastika posturale globale (Metoda Mezieres)
- ☒ Hidrokinezoterapia
- ☒ Taping neuromuskular
- ☒ Terapia fizike instrumentale
- ☒ Reabilitimi pediatrik
- ☒ Hipertermia
- ☒ Laser Yag
- ☒ Terapia me goditje
- ☒ Tekarterapia
- ☒ Elektrostimulimi
- ☒ Magnetoterapia
- ☒ Ultratingujt

Terapitë mund të alternohen në bazë të nevojave ose protokolleve të përcaktuara nga mjeku.

- Për informacion dhe shërbime, mund të kontaktoni numrat +355 4 22 73 296 ose të shkruani në adresën e mëposhtme: fizioterapia@fzkm.org, ose të vizitoni faqen www.zoja.al.



Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Klinika e Fizioterapisë dhe Rehabilitimit bashkëpunon me disa institucione akademike italiane dhe kontribuon në formimin dhe diplomimin e studentëve të Programit të Studimeve në Fizioterapi të Universitetit Katolik “Nostra Signora del Buon Consiglio”.

Poliambulanca “P. Luigi Monti”

Poliambulatori “Padre Luigi Monti” në “Rrugën e Kavajës” nr. 120, ndodhet në qendër të qytetit të Tiranës dhe, prej më shumë se 23 vjetësh, ofron një shërbim të kualifikuar për diagnozën dhe terapitë e cilësisë së lartë, falë bashkëpunimit me specialistë të ndryshëm.

Poliambulatori disponon personel mjekësor dhe paramjekësor të specializuar, pajisje moderne dhe efikase, si dhe sisteme informatike në zhvillim të vazhdueshëm për rezervimin dhe menaxhimin e të dhënave, për arritjen e diagnozave të sakta.

Poliambulatori ofron specialitetet e mëposhtme: Alergologji, Angiologji, Dermatologji, Diabetologji, Endokrinologji, Gastroepatologji, Ginekologji, Kirurgji e Përgjithshme, Endoskopi, Kardiologji, Kardiologji Pediatrike, Pneumologji, Neurologji, Ortopedi, Onkologji, ORL, Reumatologji, Mjekësi e Brendshme, Urologji.

Në radiologji, në “Poliambulatorin P. Monti”, ofrohen shërbimet e mëposhtme:

- **Radiologji Tradicionale (RX)**
- **Ekografi**
- **Mamografi**
- **Dexa**

Laboratori i Analizave i “Poliambulatorit P. Luigi Monti” është i organizuar në:

1. **Biokimik**
2. **Mikrobiologji**
3. **Anatomia patologjike (Pap Test, Biopsi, Citologji, Imunohistokimi)**
4. **Biologji Molekulare**

• Për informacion dhe shërbime, mund të kontaktoni numrat +355 42 22 39 06, ose +355 42 23 20 21, WhatsApp +355 69 70 77 550 ose të shkruani në email poliambulanca@fzkm.org, ose të vizitoni faqen www.zoja.al.



Çfarë duhet të dini

Ti je në qendër të asistencës shëndetësore.

Pyet nëse ke pyetje.

Nëse nuk kupton, pyet përsëri.

Kujdesu për trajtimet që po merr.

Sigurohu gjithmonë të kesh trajtimet dhe medikamentet e duhura.

Eduko veten në mënyrë që të kuptosh plotësisht diagnozën dhe trajtimin që duhet të marrësh.

Mëso cilat barna merr dhe pse i merr ato.

Merr pjesë në të gjitha vendimet mbi trajtimin tënd.



Të drejtat e pacientit dhe përgjegjësitë

Duam të të inkurajojmë, si pacient i Spitalit Katolik “Nostra Signora Del Buon Consiglio” që te flasësh hapur me stafin shëndetësor.

Promovo sigurinë tënde duke qenë i informuar mirë dhe i angazhuar në kujdesin tënd.

Ju keni të drejtën për të:

1. Marrë kujdes të përkushtuar, me respekt dhe mirësi në një ambient të sigurt, pa marrë parasysh moshën, gjininë, racën, kombësinë, fenë, orientimin seksual, identitetin gjinor, apo aftësitë fizike ose mendore;
2. Marrë ndihmë në një ambient të sigurt, të lirë nga çdo formë abuzimi, neglizhence apo keqtrajtimi;
3. Kuruar në një ambient që ruan dinjitetin dhe një imazh pozitiv për veten;
4. Njohur emrat e mjekëve, infermierëve dhe të gjithë personelit shëndetësor dhe administrativ;
5. Parë dhe/ose marrë një kopje të raportit, të ekzaminimit të bërë ose të Kartelës Klinike;
6. Informoheni nga mjeku në lidhje me diagnozën tuaj, parashikimin dhe përfitimet dhe rreziqet e trajtimit, rezultatet e pritura dhe rezultatet e papritura;
7. Të keni të drejtën dhe detyrën për të dhënë pëlqimin e informuar me shkrim para se të fillojë procedura;
8. Të keni të drejtën e privatësisë;
9. Të keni të drejtën mbi konfidencialitetin e trajtimeve.

Ju keni detyrën dhe përgjegjësinë për të:

1. Ofruar informacione të plota dhe të sakta, përfshirë emrin e plotë, adresën, numrin e telefonit, datëlindjen, kartën e identitetit, kodin fiskal, sigurimin dhe çdo gjë tjetër që kërkohet prej saj;
2. Ofruar informacione të plota dhe të sakta mbi shëndetin tuaj dhe histori mjekësore të mëparshme, përfshirë gjendjet aktuale, sëmundjet e kaluara, qëndrimin në spital, ilaçet, vitaminat, produktet bimore dhe çdo informacion tjetër që lidhet me shëndetin tuaj;
3. Bërë pyetje kur nuk kupton informacionet ose udhëzimet që i jepen;
4. Nëse beson se nuk mund të ndiqni planin e trajtimit, keni përgjegjësinë tua thoni mjekut. Nëse nuk ndiqni planet e kujdesit, trajtimit dhe ndihmës, do të jeni përgjegjës për rezultatet;
5. Të merrni pjesë aktivisht në menaxhimin e dhimbjes, duke mbajtur mjekët dhe infermierët të informuar mbi efektivitetin e trajtimit;



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

6. Të lini objekte me vlerë në shtëpi dhe të sillni vetëm artikujt e nevojshëm për qëndrimin tuaj në spital.
7. Trajtoni me mirësjellje të gjithë anëtarët e stafit, pacientët e tjerë dhe vizitorët;
8. Siguroni informacion të plotë dhe të saktë mbi ndonjë sigurim shëndetësor që mund të keni;
9. Jini përgjegjës për mbajtjen e takimeve, për të qënë në kohë dhe për të telefonuar Spitalin për të anuluar takimin.



Marrëveshjet dhe Sigurimet

Spitali është i lidhur për pranimet dhe për shërbimet ambulatoriale me shumicën e kompanive të sigurimeve që menaxhojnë polica shëndetësore dhe me shumë kompani e organizata. Është vetë kompania e sigurimit që merr përsipër drejtpërdrejt pagesën e shërbimeve klinike të ofruara. Duhet të mbahet parasysh se kompania e sigurimit, përderisa merr përsipër përgjegjësinë direkte për pagesën, mund ta ofrojë atë ose tërësisht ose pjesërisht. Në rastin e pagesës pjesore nga ana e kompanisë së sigurimeve, pagesa e pjesës së mbetur është përgjegjësi e pacientit. Mund të ndodhë gjithashtu që pacienti, përderisa përfiton nga një çmim i zbritur, të paguajë plotësisht shërbimet e ofruara nga Spitali Katolik dhe më pas të kërkojë rimbursimin, të plotë ose pjesor, nga kompania e tij e Sigurimit.

Kërkim kopjeje të përshkrimit të vizitave/diagnostikimeve

Është e mundur të kërkonit me pagesë kopjen e raporteve (Kartela klinike, Radiologji dhe Laboratori i Analizave, etj.):

- duke dërguar një email në adresën info@zoja.al duke treguar emrin, mbiemrin e pacientit dhe ditën e shërbimit.
- është e mundur të kontaktoni numrat +355 44 505 004, WhatsApp +355 69 70 77 550.

Për më shumë informacion, mund të konsultoni faqen www.zoja.al.

Shërbime të tjera

WI-FI falas: Spitali Katolik NSBC ofron pacientëve dhe shoqëruesve të tyre akses në internet përmes WI-FI. Shërbimi është falas dhe lejon navigimin me pajisjet tuaja mobile personale (smartphone, tablet ose PC) me qetësi dhe siguri, sipas politikës së Fondacionit NSBC. Në zonat e pritjes dhe në qendrat e shërbimit ka udhëzime për përdorimin e tij.

Për t'u lidhur me rrjetin Wi-Fi, është e nevojshme të lidhni pajisjen tuaj me rrjetin "WIFI-Guest" dhe të vendosni kredencialet tuaja.

Parkimi: Spitali Katolik NSBC disponon parkim, i rezervuar për pacientët dhe familjarët.

Persona me aftësi të kufizuara: Në katin e parë të hyrjes janë të disponueshme karroca për përdorim brenda spitalit. Të gjithë parkimet e kampusit kanë vende të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht parkimi i Spitalit.

Bar / Restorant: Në kampusin e Fondacionit ndodhet një bar dhe një vend për të ngrënë për vizitorët dhe familjarët: ai ndodhet pranë Qendrës së fizioterapisë.

Bankomat:

Në katin e parë (pranë hyrjes dhe arkës), ka një sportel Bankomat.

Duhani:

Duhani lejohet vetëm në zonat e jashtme të rezervuara për duhanpirësit:

- në kopshtin përpara hyrjes kryesore;
- në kopshtin pranë daljes së emergjencës.



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Opinion për shërbimet tona

Do të vlerësonim nëse mund të kaloni disa minuta për të plotësuar pyetësonin e vlerësimit. Këto sondazhe na ndihmojnë të sigurohemi që po ofrojmë shërbimin më të mirë të mundshëm për pacientët. Prandaj, nëse një infermiere, një asistente mjekësore ose ndonjë anëtar tjetër i ekipit tuaj të kujdesit shëndetësor meriton një lëvdatë, ju lutemi përfshini emrin e tij/saj në sondazh.

Informacione të dobishme

Orari i hapjes

Spitali Katolik është i hapur 24 orë.

Për aktivitetet ambulatoriale, analizat e laboratorit, radiologjinë ambulatoriale, orari i hapjes është nga e Hëna në të Premte nga ora 07:30 deri në ora 19:30, dhe të Shtunën nga ora 07:30 deri në ora 13:30.

Spitali mbetet i mbyllur për aktivitetet ambulatoriale, gjatë të gjitha festave vjetore, kombëtare dhe lokale.

Prenotime

Për të rezervuar vizita dhe analiza:

- personalisht, pranë recepsionit të Spitalit
- me telefon në nr. +355 44 505 004, WhatsApp +355 69 70 77 550
- me email: info@zoja.al



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Dokumente të nevojshme

Marrja e shërbimit shëndetësor privat i lejon pacientit të zgjedhë mjekun që do të kryejë vizitën specialiste, analizën, etj.

Për shërbimet e diagnostikës imazherike, gjithmonë është e nevojshme kërkesa e një specialisti, dhe për një diagnozë të saktë janë të rëndësishme analizat paraprake.

Tarifat

Për shërbimet aplikohet lista e çmimeve që do të gjeni pranë Spitalit Katolik "Nostra Signora Del Buon Consiglio".

Mënyra e pagesës

Pagesat për shërbimet mund të bëhen në para, me kartë krediti ose me transfertë bankare.

Si të na arrini

Spitali Katolik "Nostra Signora Del Buon Consiglio" ndodhet në "Rrugën Dritan Hoxha" dhe me hyrjen drejtpërdrejt në spital nga "Rruga Ana Komnena, Nr. 74, 1023" Laprakë – Tiranë.

Spitali Katolik disponon parkim të brendshëm falas. Ai ndodhet në afërsi të Sheshit Skënderbej dhe është lehtësisht i arritshëm edhe me këmbë ose me transport publik.

Tel: +355 44 50 50 04,

WhatsApp +355 69 70 77 550

E-mail: info@zoja.al

Kjo Kartë Shërbimesh është gjithashtu e disponueshme në faqen www.zoja.al dhe pranë Pranimit të Spitalit.

Drejtoria



Spitali Katolik

Zoja e Këshillit të Mirë

Përkushtuar Shëndetit Tënd

Universiteti “Katolik Zoja e Këshillit të Mirë”

Universiteti Katolik “Nostra Signora del Buon Consiglio” është një Universitet i dedikuar formimeve në shkencat mjekësore (Mjekësi, Farmaci, Infermieristikë, Fizioterapi), shkencat ekonomike dhe arkitekturë, i karakterizuar nga një frymë ndërkombëtare, dhe ngushtësisht i integruar me “*Spitalin Katolik*” dhe “*Poliambulatorin P. Monti*.”

Universiteti përgatit studentët e tij për të përballuar çdo rrugëtim karriere, si në klinikë ashtu edhe në kërkimin shkencor, në Shqipëri apo jashtë saj. Ai ofron diploma të përbashkëta me universitete italiane (Roma Tor Vergata, Bari, Firenze). Titujt e fituar pranë Universitetit Katolik “Nostra Signora del Buon Consiglio” kanë vlerë ligjore në BE.

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” ofron këto programe studimi:

- ☑ **Programi i Studimeve Master në Mjekësi dhe Kirurgji, në italisht dhe anglisht;**
- ☑ **Programi i Studimeve Bachelor në Infermieristikë, në italisht;**
- ☑ **Programi i Studimeve Bachelor në Fizioterapi, në italisht;**
- ☑ **Programi i Studimeve në Farmaci**
- ☑ **Programi i Studimeve në Ekonomi**
- ☑ **Programi i Studimeve në Arkitekturë**

Në fushën e formimit pas diplomimit, *Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”* ka marrë akreditimin e disa shkollave të specializimit për specializimet më të rëndësishme pas Diplomës në Mjekësi dhe Kirurgji, si dhe disa Mastera në Mjekësi dhe Infermieristikë.

Kampusi i *Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”* ndodhet në rrugën Dritan Hoxha, përgjatë autostradës Tiranë-Durrës: mbi 12 mijë m² me ndërtesa të dedikuara për mësimdhënie dhe laboratorë, shërbime për studentët, duke përfshirë hapësira për studim dhe zona të dedikuara për sport. Hapësirat, të zhytura në gjelbërim, janë konceptuar sipas standardeve më moderne në terma të teknologjisë dhe komfortit mjedisor.

Për më shumë informacion:

☑ **personalisht, pranë recepsionit të Universitetit;**

☑ **me telefon në nr. +355 42 273 290**

☑ **me email: info@unizkm.al**

www.unizkm.al